



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, e konform nenit 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim bëhet kompensimi i Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane për tërë territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 2

2.1 Për punën që do ta kryej Kryetari i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, do të kompensohet nga 50€, për çdo takim që do ta mbajë me Kryetarin e Komunës ose me Kryesuesin e Kuvendit, për pjesëmarrje në takimet konsultative, debate publike, konsultime publike me qytetaret dhe çështje tjera të caktuar me interes për komunitetin.

2.2 Kompensimi i Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane bëhet nga mjetet buxhetore të Komunës së Suharekës.

Neni 3

Kryetari i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, nuk mund të kompensohet apo paguhet më shumë se 6, (gjashtë) takime të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 4

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës, përkatësisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI